



Dhoma Ekonomike e Grave të Kosovës
Kosovo Women's Chamber of Commerce
Privredna Komora Žena Kosova

Për: Grupet Parlamentare, Komisioni për Legjislacion, Mandate, Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe Mbikëqyrjen e Agjencisë Kundër Korrupsionit

Nga: Dhoma Ekonomike e Grave të Kosovës – G7

Tema: Qëndrim i Dhomës Ekonomike të Grave të Kosovës – G7 në lidhje me Projektligjin për Gjykatën Administrative dhe reformat në drejtësinë komerciale

Datë: 18 prill 2024

Të nderuar Kryetarë të Grupeve Parlamentare, Anëtarë të Komisionit Parlamentar për Legjislacion, Mandate, Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe Mbikëqyrjen e Agjencisë Kundër Korrupsionit,

Në emër të Dhomës Ekonomike të Grave të Kosovës – G7, përmes kësaj shkrese, ju drejtohem lidhur me Vendimin nr. 03/188, të datës 14.02.2024 të Qeverisë së Republikës së Kosovës, për aprovimin e Projektligjit për Gjykatën Administrative.

Dhoma Ekonomike e Grave të Kosovës-G7 përshëndet iniciativën për themelimin e Gjykatës Administrative, si një gjykatë që do të trajtojë lëndët administrative, të ndara si nga kompetenca lëndore ashtu edhe ajo territoriale. Megjithatë, një nga çështjet që parasheh Projektligji në fjalë, është transferimi i kompetencave nga Gjykata Komerciale në Gjykatën Administrative, për të zgjidhur lëndët administrative dhe fiskale, ku palë janë bizneset. Sipas vlerësimit të komunitetit të bizneseve të grave, të përfaqësuar nga Dhoma Ekonomike e Grave të Kosovës-G7, konsiderojmë se ky transferim i kompetencave nuk përbën një avancim në kuptim të sundimit të ligjit dhe qasjes në drejtësi.

Komuniteti i bizneseve në Kosovë ka qenë ndër avokuesit e parë, që në vitin 2016, për themelimin e Gjykatës Komerciale. Nga diskutimet e komunitetit të biznesit në atë kohë, është parashtruar nevoja urgjente që çështjet e natyrës komerciale, ku përfshihen çështjet fiskale, tatimore, doganore dhe kontestet e natyrës investive, të trajtohen nga një gjykatë e specializuar, e cila ndër të tjera do të përfaqësohej nga profesionistë të fushës së drejtësisë komerciale, përfshirë bashkëpunëtorë profesional dhe ekspertë, të cilët do të mundësonin trajtimin e mirëfilltë dhe në kohë të arsyeshme të këtyre kontesteve.

Me themelimin e Gjykatës Komerciale, në gusht të vitit 2022, u jetësua kjo iniciativë dhe nevojë e komunitetit të biznesit. Parashikueshmëria në konteste të natyrës komerciale, trajtimi i drejtë dhe i shpejtë i kontesteve mes sektorit privat dhe atij publik, si dhe adresimi i kontesteve tregtare në një adresë, ka dhënë rezultatet e para brenda vitit të parë të themelimit të Gjykatës. Ndonëse në mungesë të gjyqtarëve dhe stafit të nevojshëm për përmbushjen e suksesshme të mandatit të Gjykatës Komerciale, sipas të dhënave të publikuara nga Këshilli Gjyqësor i Kosovës, gjatë vitit

Adresa:
Pallati i Mediave
10000 Prishtinë
Kosovë

Email: g7kosova.info@gmail.com
Tel: +383.49.174-856
www.g7kosova.org

2023, Gjykata Komerciale ka shënuar një rritje të ndjeshme, prej mbi 96%, të numrit të rasteve të zgjidhura.

Themelimi i Gjykatës Administrative në anën tjetër, padyshim që mund të rris efikasitetin e trajtimit të kontesteve mes qytetarëve dhe sektorit publik dhe atij privat. Gjithsesi, si komunitet i biznesit, Dhoma Ekonomike e Grave të Kosovës-G7, shpreh shqetësimin fillimisht rreth procesit të hartimit të Ligjit. Duhet theksuar, se komuniteti i biznesit në Kosovë nuk është përfshirë qoftë në kuadër të dizajnit të kësaj politike publike, qoftë në kuadër të hartimit të ligjit, dhe për më shumë nuk ka qenë pjesë e procesit konsultativ, si palë me interes. Në anën tjetër, konsiderojmë se transferimi i disa kompetencave nga Gjykata Komerciale në Gjykatën Administrative, siç është paraparë me Projektligjin për Gjykatën Administrative, mund të ndikojë negativisht në garantimin e parimit të sigurisë juridike në vend.

Një veprim i tillë, përveç që do të minonte punën e Gjykatës Komerciale deri më sot, i njejtë do të ndikonte edhe në humbjen e qëllimit të vet krijimit të Gjykatës Komerciale, si një adresë e vetme për të gjitha kontestet e komunitetit të biznesit. Në një situatë të tillë, Kosova do të kthehej në periudhën para reformës në drejtësinë komerciale, ku dy departamente të ndryshme kanë trajtuar konteste të ndryshme të bizneseve. Nga një Gjykatë e profilizuar dhe specializuar për të gjitha kontestet komerciale, përfshirë edhe ato me organet e pushtetit qendror dhe lokal, Gjykata Komerciale do të shndërrohej në një adresë vetëm për kontestet tregtare mes bizneseve, e që nuk përkon aspak me nevojën dhe arsyen e themelimit të saj.

Sundimi i ligjit dhe siguria juridike në Republikën e Kosovës janë qenësore, përveç tjerash edhe për rritjen e investimeve të huaja dhe vendore. Ndërkaq, sundimi i ligjit ndërlihet ngushtë me efikasitetin e gjyqësorit dhe parashikueshmërinë e mjedisit investiv. Për më shumë, konsiderojmë se koncentrimi i të gjitha kontesteve të bizneseve në një adresë të vetme, do lehtësonte dhe njëherësh mundësonte monitorimin e problematikave dhe trendeve, të cilat do shërbenin për avancimin proceseve politikëbërëse dhe ligjëbërëse në fushën tregtare në veçanti, dhe të zhvillimit ekonomik në përgjithësi. Kjo ndërkaq, është në linjë edhe me agjendën e avancimit të barazisë gjinore në fushën e ndërmarrësisë, pasi ndihmon institucionet politikëbërëse në të kuptuarit e drejtë të sfidave dhe problematikave, që gratë hasin në procesin e të bërit biznes. Bizneset e grave deri më sot përbëjnë vetëm 15% të bizneseve në vend. Rrjedhimisht, një qasje e mirëfilltë në drejtësi, përveç që do lehtësonte dhe përshpejtonte realizimin e të drejtave të grave në biznes, në anën tjetër do ndihmonte edhe në zvogëlimin e barrës administrative dhe kohës së shpenzuar në procese gjyqësore.

Për më shumë, parimi i sigurisë juridike nënkupton që korniza dhe garancitë ligjore të mos pësojnë ndryshime të shpeshta; të jenë të nevojshme dhe të bazuara në evidencë; si dhe të derivojnë nga procese konsultative me të gjitha palët e interesit. Tani kur kanë kaluar më pak se dy vite nga themelimi i Gjykatës Komerciale, dhe sukseset e të njetës janë të matshme dhe të prekshme për komunitetin e biznesit, çfarëdo largimi i kompetencave, do të ndikonte negativisht dhe do shperfillte angazhimin e vazhdueshëm të partnerëve vendorë dhe ndërkombëtarë në fuqizimin e mekanizmave të drejtësisë komerciale, si dhe në kontekst të përmirësimit të perceptimit të ambientit të të bërit biznes në Kosovë.

Adresa:
Pallati i Mediave
10000 Prishtinë
Kosovë

Email: g7kosova.info@gmail.com
Tel: +383.49.174-856
www.g7kosova.org

Për fund, në emër të Dhomës Ekonomike të Grave të Kosovës-G7, konsiderojmë se fragmentalizimi i kompetencave të Gjykatës Komerciale përmes Ligjit për Gjykatën Administrative, përveç që nuk derivon nga një proces të bazuar në evidencë, transparent dhe konsultativ me komunitetin e biznesit, njëherësh ai paraqet një riorganizim të panevojshëm në sistemin gjyqësor dhe në sistemin e drejtësisë komerciale në Republikën e Kosovës.

Si komunitet i biznesit jemi të gatshëm të japim të gjithë kontributin e nevojshëm që Gjykata Administrative të marrë formën e duhur, pa cunguar reformat në fushën e drejtësisë komerciale, të cilat deri më sot kanë treguar të jenë të suksesshme dhe nevojshme.

Duke ju falenderuar për konsideratën, dhe marrjen parasysh të qëndrimit tonë lidhur me Projektligjin për Gjykatën Administrative, ne mbesim në dispozicion për konsultime shtesë sipas nevojës suaj.

Adresa:
Pallati i Mediave
10000 Prishtinë
Kosovë

Email: g7kosova.info@gmail.com
Tel: +383.49.174-856
www.g7kosova.org